



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1005/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Afrim Ramushi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1005/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Afrim Ramushi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2623D/01R, 2623D/02R, 2617D/01R, 2617D/02R, 2617D/03R, 2617D/04D, , 2628D/01D, 2620D/01R, 2620D/02R, 2620D/03R, 2605D/01R, 2605D/02R, 2605D/03R, 2605D/04R, 2605D/05R, 2603D/01R, 2603D/02R, 2603D/03D, 2630D/01R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.1005/2021 me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Afrim Ramushi nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, në të cilën pretendon se në vendvotimet 2623D/01R, 2623D/02R, 2617D/01R, 2617D/02R, 2617D/03R, 2617D/04D, , 2628D/01D, 2620D/01R, 2620D/02R, 2620D/03R, 2605D/01R, 2605D/02R, 2605D/03R, 2605D/04R, 2605D/05R, 2603D/01R, 2603D/02R, 2603D/03D, 2630D/01R, pas numërimit të rezultateve ka mos përputhje të rezultateve dhe kërkon që të rinumërohen këto vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë Afrim Ramushi nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet e cekura më lartë nuk ka bashkangjitur deklarata me emrat e dëshmitarëve pos vetëm emrat e dëshmitarëve çka nuk paraqet prova bindëse.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1005/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesë e Panelit
Milena Đerić**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.